



Prishtinë, 27.11.2019

Kodi i ZRRE-së V_1205_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e nenit 9, neni 16 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 dhe 1.10, nenin 25, nenin 55 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe 1.5, Nenin 54 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 55 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.2 dhe 1.5 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligji Nr. 05/L-084,
- Dispozitat e Nenin 3 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, paragrafin 3, 4,5,6 dhe 7, Nenin 4 paragrafi 1, nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi. 1.1 dhe Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.3 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat,
- Dispozitat e Nenit 27 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes të lëshuar KEDS SH.A,
- VB_114_2018 dhe VB_117_2018 të datës 05 nëntor 2018 të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së,
- Njoftimin Nr. 520/19 të datës 05 shtator 2019 lidhur me të gjeturat e paraqitura në raportet e monitorimit,
- Përgjigjet e KEDS SH.A. të datës 07 tetor 2019 në lidhje me njoftimin Nr. 520/19 të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së,
- Sqarimin me shkrim Nr. 87/2019 të datës 16 tetor 2019 të lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik lidhur me çështjen e ngritur nga ZRRE-ja përmes shkresës Nr. 68/2019 të datës 29 shtator 2019,

në seancën e mbajtur me 27 nëntor 2019 ka nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **OBLIGOHET** - Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike KEDS SH.A., të ndërpres menjëherë kryerjen e aktiviteteve që shkaktojnë shkeljen e kushteve dhe obligimeve të parapara me Nenin 11 të Licencës së OSSH-së.
- II. **DETYROHET** - Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike KEDS SH.A. që brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pranimit apo publikimit të këtij Vendimi, të kompensojë të gjithë konsumatorët të cilët i ka ngarkuar në Pëlqimet Energjetike për pagesën e grupit matës.

A R S Y E T I M

- o Me datë 05 nëntor 2018, Bordi i ZRRE-së, në përputhje me kompetencat ligjore të dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, dhe me vendimet VB_114_2018 dhe VB_117_2018 ka themeluar grupet punuese, me qëllim të Monitorimit të Investimeve Kapitale dhe Monitorimin e Ankesave dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.



- o Grupet punuese të ZRRE-së, për zbatimin e obligimeve ligjore, kanë ndërmarr veprimeve konkrete ku, përmes komunikimeve me shkrim dhe të vizitave të realizuara në teren janë fokusuar në monitorimin e aspektit procedural, teknik dhe financiar, për të parë nëse janë respektuar kriteret e prokurimit publik, dhe monitorimin e ofrimit të shërbimeve për konsumator nga KEDS.
- o Gjatë monitorimit të investimeve kapitale, grupi monitorues ka përzgjedhur dhe analizuar disa projekte. Gjatë vlerësimit të projekteve të përzgjedhura, është vërejtur se proces i prokurimit ka mangësi në KEDS dhe nuk është bërë sipas Nenit 11 të Licencës së OSSH-së, proceduarave të parapara në Ligjin e Prokurimit Publik, përkatësisht, është konstatuar se KEDS nuk ka publikuar shprehjen e interesit në web-faqen elektronike dhe në ndonjë nga gazetatat zyrtare, nuk është bërë evidentimi i pjesëmarrësve në kuadër të procesit dhe më pastaj përzgjedhja e fituesit bazuar në kriteret teknike dhe ekonomike të definuar paraprakisht.
- o Gjatë monitorimit të procesit të ofrimit të shërbimeve për konsumator, grupi monitorues ka konstatuar që KEDS në disa raste në pëlqimet energjetike ka kërkuar pagesën e grupit matës apo edhe vendosjen e grupit matës nga vetë aplikuesi. Ky veprim i bërë nga KEDS është në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit për Energji Elektrike, pasi pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e operatorit të sistemit të shpërndarjes.
- o Grupet monitoruese të ZRRE-së, pas përfundimit të mbikëqyrjes kanë përgatitur Raportin mbi monitorimin e investimeve kapitale dhe Raportin mbi monitorimin e ofrimit të shërbimeve për konsumator, me të gjeturat mbi shkeljet eventuale të kontestuara, të cilat janë dorëzuar te Bordi i ZRRE-së, për shqyrtim.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me 28 gusht 2019, bazuar në të gjeturat e provuara në raportet e monitorimit dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ka shqyrtuar Raportet Monitoruese dhe ka kërkuar nga KEDS që në afat jo më të gjatë se 30 ditë nga data e pranimit të njoftimit për mos pajtueshmëri të informojë Bordin e ZRRE-së, lidhur me veprimet që do të ndërmerren për përmirësimin e parregullsive të konstatuara në raportet e monitorimit.
- o Me datë 07 tetor 2019, KEDS ka dorëzuar në ZRRE komentet në lidhje me njoftimin për mos pajtueshmëri. KEDS në komentet e saj kishte theksuar se nuk është ndërmarrje publike në pronësi të Republikës së Kosovës siç përcaktohet në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, por është një kompani private me kapital privat, konform Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë tregtare.
- o Për më tepër, ata theksojnë se marrëveshja e Implementimit specifikon gjithashtu në Nenin 4.9 "Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve", veçanërisht në Nenin 4.9.2 se KEDS-it, i lejohej të prokurojë mallra dhe shërbime në kushte komerciale dhe mbi bazën e zgjatjes së dorës (në bazë të marrëveshjes me palët tregtuese) ose afërsinë e tyre. KEDS përmes procedurave të brendshme të prokurimit tashmë garanton përzgjedhjen në bazë të konkurrencës, kushteve



komerciale dhe zgjatjes së dorës. Pas privatizimit, përmes procedurave të brendshme, të cilat janë hartuar bazuar në kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik, KEDS ka ndjekur parimet e përgjithshme të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Sidoqoftë, për të shmangur çdo interpretim të gabuar dhe për të sqaruar qartë kërkesat ligjore, KEDS ka kërkuar sqarim ligjor nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP).

- o Në komentet e saj KEDS kishte theksuar se do të përmirësojë çështjet në lidhje me proceset e tenderimit duke bërë përgatitjet e nevojshme për shpalljen e tyre përmes ueb-faqes në internet, përfshirë edhe njoftimet për specifikat kryesore të materialeve dhe të tjera, që të gjitha këto në kontekstin e bërjes së proceseve të prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve, në përputhje me kornizën ligjore.
- o Me datë 29 shtator 2019, Zyra e Rregullatorit për Energji përmes shkresës Nr.68/2019 ka njoftuar Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik me të gjeturat e Raportit të Monitorimit dhe kishte kërkuar interpretim të dispozitave të LPP.
- o Me datë 17 tetor 2019, Zyra e Rregullatorit për Energji përmes shkresës Nr. 87/2019 ka pranuar sqarimet e nevojshme nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Në këtë shkresë, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kishte bërë të qartë se sipas Nenit 2 të Ligjit të Prokurimit Publik, autoritet kontraktuese janë të obliguara gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit të respektojnë kërkesat procedurale dhe materiale të këtij ligji. Prandaj, Neni 2 i LPP aplikohet për çdo Operator të Shërbimeve Publike (që të dyja të natyrës publike ose private) për të cilat kërkohet që detyrimisht në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit t'i respektojnë kërkesat procedurale dhe materiale të këtij ligji.
- o KEDS në përgjigjet e saj në lidhje me ofrimin e shërbimeve për konsumator, kishte potencuar faktin që ky ka qenë një proces i trashëguar përkundër faktit që përgjatë viteve KEDS vazhdimisht ka minimizuar aplikimin e këtij procesi. KEDS është pajtuar me konstatimet e ZRRE-së, që kjo ngarkesë të mos aplikohet dhe në këtë kontekst të gjithë konsumatorët të cilët i janë nënshtruar kësaj ngarkese përgjatë periudhës monitoruese do të kompensohen, edhe pse kjo vlerë është zbritur si e hyrë e parregulluar gjatë përcaktimit të Hyrave të Lejuara Maksimale (HLM) për vitin përkatës. Për më tepër, KEDS tashmë ka filluar të ndërmerr masat e nevojshme në këtë drejtim duke njoftuar konsumatorët e afektuar nga ky proces dhe ka kërkuar nga të njëjtit që të dorëzojnë informatat e nevojshme mbi kompensimin të mjeteve.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas vlerësimit dhe analizimit të tërë dokumentacionit që ka pasur të bëjë me procesin e monitorimit dhe përgjigjeve të paraqitura nga KEDS SH.A., ka ardhur në përfundim se nga përgjigjet e dhënura të KEDS SH.A, nuk janë kontestuar shkeljet e evidentuara në raportet e monitorimit nga ana e grupeve monitoruese të ZRRE-së, dhe bazuar në atë që u sqaruan më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.



IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KEDS SH.A,
- Arkivit të Rregullatorit.